

Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit 20

Kontabiliteti i Granteve Qeveritare dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese për Ndhimën Qeveritare

Objekti

- 1 Ky Standard duhet të zbatohet për trajtimin kontabël dhe për dhënen e informacioneve shpjeguese për grantet qeveritare dhe për dhënen e informacioneve shpjeguese për format e tjera të ndihmës qeveritare.
- 2 Ky Standard nuk trajton:
 - (a) probleme të veçanta që dalin në trajtimin kontabël të granteve qeveritare në pasqyrat financiare të cilat pasqyrojnë efektin e ndryshimit të çmimeve ose në informacionin shtesë me natyrë të ngjashme;
 - (b) ndihma qeveritare që i jepet një njësie në formën e përfitimeve që janë të disponueshme në përcaktimin e të ardhurave të tatueshme ose që përcaktohen ose kufizohen në bazë të detyrimit për tatimin mbi të ardhurat (të tilla si tatimi mbi të ardhurat e pushimve, kreditimi i tatimit mbi investimet, zbritjet e amortizimit të përshpejtuar dhe pakësimi i normës së tatimit mbi të ardhurat);
 - (c) pjesëmarrjen e qeverisë në pronësinë e një njësie ekonomike;
 - (d) grantet qeveritare të trajtuara nga SNK 41 *Agrikultura*.

Përkufizime

- 3 Në këtë standard termat e mëposhtme janë përdorur me këto kuptime:

Qeveritare i referohet qeverisë, agjencive qeveritare dhe njërive të ngjashme, qofshin këto lokale, kombëtare ose ndërkombëtare.

Ndihma qeveritare është një veprim i qeverisë i projektuar për të dhënë një përfitim ekonomik të caktuar për një njësi ekonomike ose një grup njësisish ekonomike që plotësojnë kritere të caktuara. Për synimet e këtij Standardi ndihma qeveritare nuk përfshin vetëm përfitimet e dhëna në mënyrë jo të drejtpërdrejtë nga veprimi që ndikon kushtet tregtare në përgjithësi, të tilla si ngritja e infrastrukturës në zonat në zhvillim ose vendosja e kufizimeve tregtare mbi konkurruesit.

Grantet qeveritare janë ndihma nga qeveria në formën e transferimit të burimeve tek një njësi ekonomike në këmbim të plotësimin, në të shkuarën ose në të ardhmen, të disa kushteve që lidhen me aktivitetet operative të njësisë ekonomike. Përjashtohen ato forma të ndihmës qeveritare të cilave nuk mund t'u jepet vlerë në mënyrë të arsyeshme dhe ato transaksione me qeverinë të cilat nuk mund të dallohen nga transaksionet normale tregtare të njësisë ekonomike.¹

Grantet e lidhura me aktivitet janë grante qeveritare, kushti kryesor i të cilave është që njësi ekonomike përfituese të blejë, ndërtojë ose të marrë në një mënyrë tjetër aktive afatgjata. Mund të bashkangjiten gjithashtu kushte shoqëruese të cilat kufizojnë llojin, vendodhjen e aktiveve ose periudhat e marrjes apo mbajtjes së tyre.

Grantet e lidhura me të ardhurat janë grante qeveritare të ndryshme nga ato të lidhura me aktivitet.

¹ Shih gjithashtu KIS-10 *Ndihma Qeveritare-Pa Lidhje Specifike me Aktivitetet*

Huatë e falshme janë hua në të cilat huadhënësi heq dorë nga ripagimi sipas disa kushteve të paracaktuara.

Vlera e drejtë është shuma me të cilën mund të shkëmbehej një aktiv, ose mund të shlyhej një pasiv, midis palëve të vullnetëshme të mirëinformuara dhe të palidhura me njëra-tjetrë

- 4 Ndhima qeveritare është në forma të ndryshme që variojnë në natyrën e ndihmës së dhënë dhe në kushtet që zakonisht u bashkangjiten atyre. Qëllimi i ndihmës mund të jetë që të nxisë një njësi ekonomike të ndërmarrë një veprim të cilin normalisht nuk do ta kishte ndërmarrë nëse nuk do të ishte ofruar ndihma.
- 5 Përfitimi i ndihmës qeveritare nga një njësi ekonomike mund të jetë i rëndësishëm për përgatitjen e pasqyrave financiare për dy arsye. Së pari, nëse burimet janë transferuar, duhet të gjendet një metodë e përshtatshme kontabël e transferimit të tyre. Së dyti, është e preferueshme që të jepet një tregues i madhësië së përfitimit të njësisë ekonomike nga një ndihmë e tillë gjatë periudhës raportuese. Kjo lehtëson krahasimin e pasqyrave financiare të njësisë ekonomike me ato të periudhave paraardhëse dhe ato të njësisë të tjera.
- 6 Në disa raste, grantet qeveritare janë emërtuar si subvencione ose prime.

Grantet Qeveritare

- 7 **Grantet qeveritare, përfshirë grantet jo-monetare me vlerë të drejtë, nuk duhet të njihen derisa të mos ketë një siguri të arsyeshme se:**
 - (a) **njësia ekonomike do të plotësojë kushtet që shoqërojnë grantet; dhe**
 - (b) **grantet do të merren.**
- 8 Një grant qeveritar nuk do të njihet derisa të mos ketë një siguri të arsyeshme se njësia ekonomike do të plotësojë kushtet shoqëruese të grantit dhe se granti do të merret. Vetëm marrja e një granti nuk ofron evidencë të mjaftueshme se kushtet shoqëruese të grantit janë plotësuar ose do të plotësohen.
- 9 Mënyra sesi merret një grant nuk ndikon metodën kontabël që do të përdoret për grantin. Prandaj një grant trajtohet kontabilisht njëllor si në rastin kur ai merret në mjete monetare ashtu edhe në rastin kur merret si pakësim i një detyrimi ndaj qeverisë.
- 10 Nje hua e falshme nga qeveria trajtohet si një grant qeveritar nëse ka siguri të arsyeshme se njësia ekonomike do të plotësojë kushtet për faljen e huasë.
- 11 Pasi njihet një grant qeveritar çdo pasiv ose aktiv i kushtëzuar i lidhur me to trajtohet në përputhje me *SNK 37 Provizionet, Pasivet dhe Aktivët e Kushtëzuar*.
- 12 **Grantet qeveritare duhet të njihen si të ardhura gjatë periudhave të nevojshme për t'u krahasuar ato me kostot respektive që ato kanë për qëllim të kompensojnë, në mënyrë sistematike. Grantet nuk duhet të kreditohen drejtpërsëdrejti në kapitalin aksionar.**
- 13 Dy janë metodat kryesore të trajtimit kontabël të granteve qeveritare: metoda e kapitalit, sipas së cilës një grant kreditohet drejtpërsëdrejti në kapitalin aksionar dhe metoda e të ardhurave, sipas së cilës granti merret në të ardhurat për një ose më shumë periudha.
- 14 Mbështetësit e metodës së kapitalit argumentojnë si vijon:
 - (a) grantet qeveritare janë një mjet financimi dhe duhet të trajtohen si të tilla në bilanc dhe jo të kalohen përmes pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve për të kompensuar zërat e shpenzimeve që ato financojnë. Meqë nuk pritet ripagim prej tyre, ato duhet të kreditohen drejtpërsëdrejti në kapitalin aksionar; dhe
 - (b) është e papërshtatshme që grantet qeveritare të njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përderisa ato nuk janë fituar por përfaqsojnë një nxitje të ofruar nga qeveria pa kostot shoqëruese.
- 15 Argumentat në mbështetje të metodës së të ardhurave janë si vijon:
 - (a) përderisa grantet qeveritare merren nga një burim i ndryshëm nga aksionerët, ato nuk duhet të kreditohen drejtpërsëdrejti në kapitalin aksionar por duhet të njihen si të ardhura në periudhat e duhura;

- (b) grantet qeveritare rallëherë janë falas. Njësia ekonomike i fiton ato nëpërmjet pajtimit me kushtet e tyre dhe plotësimit të detyrimeve të parashikuara. Prandaj ato duhet të njihen si të ardhura dhe të krahasohen me kostot shoqëruese të cilat granti ka për qëllim të kompensojë; dhe
- (c) duke qenë se tatimi mbi të ardhurat dhe tatimet e tjera zbriten nga të ardhurat, është logjike që edhe grantet qeveritare që janë një shtrirje e politikave fiskale të trajtohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.
- 16 Është thelbësore për metodën e të ardhurave që grantet qeveritare të njihen si të ardhura në mënyrë sistematike dhe racionale gjatë periudhave të nevojshme për t'i krahasuar ato me kostot respektive. Njohja e të ardhurave nga grantet qeveritare në bazë të arkëtimeve nuk është në përputhje me supozimin e kontabilitetit mbi bazë konstatimesh (shih *SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare*) dhe do të jetë e pranueshme vetëm nëse nuk ekzistojnë baza për shpërndarjen e grantit gjatë periudhave përtej asaj kur është arkëtuar granti.
- 17 Në shumicën e rasteve periudhat gjatë të cilave një njësi ekonomike njeht kostot ose shpenzimet lidhur me një grant qeveritar, gjenden lehtë dhe prandaj me njohjen e shpenzimeve të caktuara, grantet njihen si të ardhura në të njëjtën periudhë si dhe shpenzimet e lidhura me to. Në mënyrë të ngjashme grantet e lidhura me aktivet e amortizueshme, zakonisht njihen si të ardhura gjatë periudhave dhe në rapoartet në të cilat ngarkohet amortizimi lidhur me këto aktive.
- 18 Grantet e lidhura me aktive jo të amortizueshme mund të kërkojnë gjithashtu plotësimin e disa detyrimeve dhe prandaj do të njihen si të ardhura gjatë periudhave që mbartin koston e plotësimit të detyrimeve. Për shembull, një grant në formën e terrenit mund të kushtëzohet me ndërtimin e një ndërtese në të dhe është e përshtatshme që të njihet si e ardhur gjatë jetës së ndërtesës.
- 19 Ndonjëherë grantet merren si pjesë e një pakete ndihme financiare ose fiskale, së cilës i bashkangjiten një sërë kushtesh. Në të tilla raste, është i nevojshëm kujdesi në identifikimin e kushteve që sjellin kosto dhe shpenzime, të cilat përcaktojnë periudhat gjatë të cilave granti do të fitohet. Mund të jetë e përshtatshme që një pjesë e grantit të shpërndahet sipas një baze dhe pjesa tjetër sipas një baze tjetër.
- 20 **Një grant qeveritar që bëhet i arkëtueshëm si kompensim për shpenzime ose humbje të ndodhura ose për dhënie ndihme financiare të menjëhershme njësisë ekonomike pa kosto të ardhshme të lidhura me to duhet të njihet si e ardhur në periudhën në të cilën ai bëhet i arkëtueshëm.**
- 21 Në disa rrethana, një grant qeveritar mund të fitohet si mbështetje financiare e dhënë menjëherë për një njësi ekonomike sesa si një nxitës për të ndërmarrë shpenzime të caktuara. Grante të tilla mund të kufizohen tek një njësi ekonomike individuale dhe mund të mos jenë të disponueshme për të gjithë klasën e përfituesve. Këto rrethana mund të garantojnë njohjen e një granti si të ardhur në periudhën në të cilën njësia ekonomike kualifikohet për ta marrë atë, duke dhënë informacionet shpjeguese për të siguruar se efekti i tij është kuptuar qartë.
- 22 Një grant qeveritar mund të bëhet i arkëtueshëm nga një njësi ekonomike si kompensim për shpenzime ose humbje të ndodhura në periudhën e mëparshme. Një grant i tillë njihet si e ardhur në periudhën në të cilën ai bëhet i arkëtueshëm, duke dhënë informacionet shpjeguese për të siguruar se efekti i tij është kuptuar qartë.

Grantet qeveritare jo-monetare

- 23 Një grant qeveritar mund të jetë në formën e transferimit të një aktivi jo monetar, si psh një terren ose burime të tjera, për t'u përdorur nga njësia ekonomike. Në këto rrethana është e zakonshme që të vlerësohet vlera e drejtë e aktivitetit jo monetar dhe të kontabilizohet si granti dhe aktivi me vlerën e drejtë. Një rrugë alternative që ndiqet ndonjëherë është që aktivi dhe granti të regjistrohen me vlerën nominale.

Paraqitja e granteve që lidhen me aktivet

- 24 **Grantet qeveritare që lidhen me aktivet, përfshirë grantet jo monetare me vlerë të drejtë, duhet të paraqiten në pasqyrën e bilancit ose duke e njohur grantin si të ardhur të shtyrë ose duke zbritur grantin që merret nga vlera e mbartur e aktivitetit.**

- 25 Dy metodat e paraqitjes në pasqyrat financiare të granteve (ose pjesëve të caktuara të granteve) që lidhen me aktivet, shihen si alternativa të pranueshme.
- 26 Njëra metodë njihet si të ardhur të shtyrë e cila njihet si e ardhur në një mënyrë sistematike dhe racionale gjatë jetës së dobishme të aktivit.
- 27 Metoda tjetër zbrit grantin që merret nga vlera kontabël e aktivit. Granti njihet si e ardhur gjatë jetës së aktivit të amortizueshëm duke pakësuar shumën e amortizimit.
- 28 Blerja e aktiveve dhe arkëtimi i granteve përkatëse mund të shkaktojë lëvizje të rëndësishme në fluksin e mjeteve monetare të një njësie ekonomike. Për këtë arsye dhe me qëllim që të tregohen investimet bruto në aktive, lëvizje të tilla shpesh paraqiten si zëra të veçantë në pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare pavarësisht nëse granti zbritet ose jo nga aktivi që lidhet me të për qëllime të paraqitjes në pasqyrën e bilancit..

Paraqitja e granteve që lidhen me të ardhurat

- 29 Grantet që lidhen me të ardhurat, ndonjëherë paraqiten si një e ardhur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, ose veçmas ose nën një grupim të përgjithshëm të tillë si “ Të ardhura të tjera”; ose ndryshe, ato zbriten në raportimin e shpenzimeve me të cilat lidhen.
- 30 Mbështetësit e metodës së parë ankohen së nuk është e përshtatshme që të kompesohen të ardhurat me shpenzimet dhe se ndarja e grantit nga shpenzimet lehtëson krahasimin me shpenzime të tjera që nuk ndikohen nga granti. Për metodën e dytë argumentohet se njësia ekonomike mund të mos i ketë bërë shpenzimet nëse granti nuk ka qenë i disponueshëm dhe paraqitja e shpenzimeve pa kompensimin e grantit mund të jetë çorientuese.
- 31 Të dyja metodat shihen si të përshtatshme për paraqitjen e granteve që lidhen me të ardhurat. Dhënia e informacioneve shpjeguese për grantin mund të jetë e nevojshme për një kuptim të plotë dhe të saktë të pasqyrave financiare. Zakonisht është e përshtatshme dhënia e informacioneve shpjeguese për efektin e granteve në një zë të të ardhurave ose shpenzimeve i cili kërkohet që të paraqitet veçmas.

Ripagimi i granteve qeveritare

- 32 Një grant qeveritar që bëhet i ripagueshëm duhet të trajtohet si një rishikim i një vlerësimi kontabël (shih *SNK 8 Politikat Kontabile, Ndryshimet në Vlerësimt Kontabël dhe Gabimet*). Ripagimi i një granti të lidhur me të ardhurat duhet të zbatohet fillimisht ndaj ndonjë të ardhure të shtyrë të paamortizuar të krijuar në lidhje me grantin. Për shumën që ripagimi tejkalon një të ardhur të tillë të shtyrë ose kur nuk ekziston një e ardhur e shtyrë, ripagimi duhet të njihet menjëherë si shpenzim. Ripagimi i një granti të lidhur me një aktiv do të regjistrohet duke rritur vlerën që mbart aktivi ose duke pakësuar tepriçën e të ardhurave të shtyra me shumën e ripagueshme. Amortizimi shtesë kumulativ që do të ishte njohur deri në këtë moment si një shpenzim në mungesë të grantit do të njihet menjëherë si shpenzim.
- 33 Rrethanat që sjellin ripagimin e një granti të lidhur me një aktiv, mund të kërkojnë që të merret në konsideratë që të bëhet një çvlerësim i mundshëm i vlerës së re që mbart aktivi.

Ndihma qeveritare

- 34 Përfshihen nga përkufizimi i granteve qeveritare të paragrafit 3 disa forma të ndihmës qeveritare të cilave nuk mund t’u jepet vlerë në mënyrë të arsyeshme dhe ato transaksione me qeverinë të cilat nuk mund të dallohen nga transaksionet normale tregtare të njësisë ekonomike.
- 35 Shembuj të ndihmës që nuk mund t’i jepet një vlerë në mënyrë të arsyeshme janë këshillat falas teknike ose marketingu dhe dhënia e garancive. Një shembull i ndihmës që nuk mund të dallohet nga transaksionet e zakonshme tregtare të njësisë ekonomike, është një politikë prokurimi qeveritare e cila është përgjegjëse për një pjesë të shitjeve të njësisë ekonomike. Prania e përfitimit mund të jetë shumë e qartë por çdo përpjekje për t’i ndarë aktivitetet tregtare nga ndihma qeveritare mund të jetë arbitrare.

- 36 Rëndësia e përfitimit në shembujt e mësipërm mund të jetë e tillë që dhënia e informacioneve shpjeguese lidhur me natyrën, madhësinë dhe kohëzgjatjen e ndihmës është e nevojshme me qëllim që pasqyrat financiare të mos jenë çorientuese.
- 37 Huatë me norma të ulëta interesi ose zero, janë një formë e ndihmës qeveritare, por përfitimi nuk është i matshëm nëpërmjet llogaritjes së interesit.
- 38 Në këtë Standard, ndihma qeveritare nuk përfshin sigurimin e infrastrukturës nëpërmjet përmirësimit të rrjetit të përgjithshëm të transportit dhe të komunikimit si dhe ofrimin e shërbimeve të përmirësuara si vaditje ose mbulim me rrjet ujot, të cilat janë të disponueshme në një bazë të vazhdueshme e të papërcaktuar për përfitime nga gjithë komuniteti lokal.

Dhënia e informacioneve shpjeguese

- 39 Duhet të jepet informacion shpjegues për çështjet në vijim:
- (a) politika kontabël e përdorur për grantet qeveritare, përfshirë metodat e përdorura të paraqitjes në pasqyrat financiare;
 - (b) natyra dhe madhësia e granteve qeveritare të njihura në pasqyrat financiare dhe një tregues për format e tjera të ndihmës qeveritare prej të cilave njësia ekonomike ka përfituar drejtpërsëdrejti; dhe
 - (c) kushtet e paplotësuara dhe kushte të tjera të lidhura me ndihmën qeveritare të cilat janë njohur.

Dispozita kalimtare

- 40 Një njësi ekonomike që përdor këtë Standard për herë të parë duhet:
- (a) të pajtohet me kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese kur është e nevojshme; dhe
 - (b) ose:
 - (i) të rregullojë pasqyrat e saj financiare për ndryshimet në politikën kontabile në përputhje me SNK 8; ose
 - (ii) të zbatojë kërkesat kontabël të Standardit vetëm për grante ose pjesë grantesh që bëhen të arkëtueshme ose të ripagueshme pas hyrjes në fuqi të Standardit.

Data e hyrjes në fuqi

- 41 Ky Standard bëhet i zbatueshëm për pasqyrat financiare që mbulojnë periudha që fillojnë në ose pas datës 1 Janar 1984.